

# Vetëlavderimi nuk është polemikë serioze

nga Kastriot Myftaraj

Kundër-replika e «Murat Bashës», me titull «E vërteta nuk mund të përballet», e botuar në ditoren «TemA» të datës 14 nëntor 2004, nga pikëpamja e ballafaqimit të ideve, nuk përbën një polemikë serioze dhe të denjë për të marrë një përgjigje. Kjo për faktin se «Murat Basha» nuk bën objeksione mbi tezat e paraqitura prej meje në shkrimin me të cilin «Murat Basha» replikon. Autori, në këtë shkrim, kryesisht bën vetëlavdërime, çka mund të përbëjnë konvencione personale në mjediset politike ku ai militon, por asesi nuk përbëjnë teza të vlefshme në një debat intelektual të këtij lloji.

Gjithsesi, unë e gjej si obligim që t' i përgjigjem edhe për shkak se ajo pjesë e shkrimit që nuk përbëhet nga vetëlavdërime, përbëhet nga denigrime në adresë të personit tim, çka e bën reagimin tim të paevitueshëm.

Murat Basha përgënjeshton Murat Bashën

«Murat Basha» e fillon shkrimin e vet duke pranuar se zëdhënësi i «Oborrit Mbretëror», që sot në mënyrë kurioze dhe sinjifikative gjendet në Vishnje, pranë Baldushkut, në rrethinat e Tiranës, nuk ka qenë në vitin 1994 pjesëmarrës në delegacionin e zogistëve që shkoi të takonte Leka Zogun në Johaneshburg. Kur replikuesi ka dizinformuar për këtë gjë, ai ka humbur kredibilitetin për të qenë i besueshëm edhe për gjëra të tjera, si p.sh. cili është kordinator diplomatik i LZHK, gjendja shëndetësore e Leka Zogut, pronari i vilës ku jeton ky i fundit etj.

Natyrisht që replikuesi, pasi ka dizinformuar, ka humbur kredibilitetin për të qenë i besueshëm në arsyen që jep për mosvajtjen e Gërmenjit në Afrikën e Jugut, duke thënë se u ndalua nga autoritetet shqiptare që të shkojë atje. Replikuesi harron se në shkrimin e mëparshëm ka thënë se Gërmenji u pushua nga puna pikërisht për faktin se shkoi në Johaneshburg. Tash replikuesi ka edhe detyrimin që të na sqarojë se përse u pushua nga puna Gërmenji kur ai nuk shkoi në Johaneshburg. Se këtu replikuesi padashje mund të hapë ndonjë histori tjetër.

Murat Basha në version filozof!?

Pasi është ngatërruar kështu me veten, replikuesit vështirë se do t' i shërbejë për ta bindur lexuesin se thotë të vërtetën, ai meditim mbi moralin dhe të vërtetën që ka bërë duke iu referuar dhe filozofëve të huaj. Deri më sot, replikuesi nuk ka shfaqur ndonjë prirje për filozofi dhe në të 26 daljet në televizion që ai thotë se ka bërë nuk ka cituar asnjëherë ndonjë filozof të huaj. Eseja filozofike mbi moralin dhe të vërtetën e shoqëruar me citimet nga filozofët e huaj në shkrimin e fundit tregojnë se «mendimtari i lirë» Arian Starova (mendimi i të cilit përputhet me atë të Nanos) qenka ingranuar në LZHK dhe i qenka bashkuar Abdi Baletës si bashkëautor i shkrimeve të nënshkuara nga Murat Basha. Unë mund ta pranoj Murat Bashën si politikan, pasi në tranzicionin shqiptar, për disa specifika kurioze, ka vend edhe për specien e çuditshme politike «Murat Basha». Por, as unë dhe asnjë njeri me dy pare mend në kokë, nuk mund të bindet se Murat Basha është i aftë të trajtojë një temë filozofike.

«Sakrificat» e Murat Bashës në shërbim të së vërtetës

Vetëlavdërimi, apo panegjeriku për vetveten i Murat Bashës arrin kulmin e patetikës, kur ai thotë: «Murat Basha i panjollë, që të gjithë e njohin për njeriun që nuk bën kompromise të ndyra me idealin dhe nuk pranon të përdhosë karakterin përkundrajt çdo çmimi apo afere. T' i shërbesh të vërtetës është detyrim moral». («TemA», 14 nëntor 2004, f. 9.)

Derisa Murat Basha ka vendosur që ta bazojë polemikën mbi lavdërimin e vetvetes dhe denigrimin tim, unë jam i detyruar t' ia them dy gjëra dhe i kërkoj («TemA»-s, që mos t' i censurojë ato. As Murat Basha, as unë nuk mund të flasim për atë sesi e njohin të gjithë Murat Bashën, pasi unë nuk e di që kohët e fundit të jetë organizuar ndonjë referendum në Republikën e Shqipërisë, ose vetëm në Tiranë, ku njerëzit të shprehin mendimin e tyre se çfarë burri është Murat Basha. Por, unë, pasi Murat Basha ka marrë përsipër t' u thotë njerëzve se kush jam unë, po u them se kush është Murat Basha.

Të gjithë duhet ta dinë se Murat Basha u bë anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës për të marrë një leje ndërtimi për një pallat atje pranë Urës së Tabakëve, ku për arsye të trashëgimisë arkitektonike nuk ka qenë lejuar të ndërtohet. Kjo leje u dha me ndërhyrjen direkte të Edi Ramës, për të cilin Basha bën be e rufe. Në një kohë që dhjetëra mijëra opozitarë të pushuar nga puna paguajnë një çmim të egër për opozitën e tyre të pakompromis me regjimin, Murat Basha, falë miqësisë së vet me Edi Ramën, arriti që ta emërojë bashkëshorten e vet në një post drejtues në Bashkinë e Tiranës. Pra, Murat Basha është persekutuar nga socialistët për shërbimin e vet në dobi të së vërtetës me leje ndërtimi e poste.

Sa për shërbimet e Murat Bashës në dobi të Tiranës mbetet t' i shohim. Deri tash kemi parë sesi Murat Basha e ka braktisur Parisin dhe Londrën-pretendimi i tij-për të ndërtuar pallate në Tiranë. Murat Basha nuk na thotë se ç' punë bënte në Paris dhe Londër që të kuptojmë unë dhe lexuesit përmasat e sakrificës së tij.

#### Krahasimi intelektual Basha-Myftaraj

Në shkrimin e vet të fundit Murat Basha bën dhe krahasimin intelektual midis ne të dyve.

Basha shkruan për mua:

«Firmëtari mund të jetë autor i tre librave dhe 200 shkrimeve, por varet se çfarë ka zhgaravitur në to, sepse tezat që ai ka hedhur në librat dhe në shkrimet e mëparshme, paturpësisht i kundërshton sot. Ndërsa unë Murat Basha, kam bërë rreth 150 shkrime deri më sot, kryesisht në gazetën “Atdheu”, rreth 26 emisione televizive dhe debate e diskure të pafundme për tema të ndryshme, gjatë punës sime të përditshme si politikan». («TemA», 14 nëntor 2004, f. 9.)

Që unë jam autor i tre librave dhe 200 shkrimeve ky është një fakt i dokumentuar. Sa për atë nëse unë në këto libra unë kam bërë «zhgarravina», siç thotë Basha, apo kam paraqitur teza serioze dhe të argumentuara, Basha duhet të bëjë një polemikë me argumente për të bindur lexuesin se unë kam bërë «zhgarravina».

Unë nuk i kam mohuar shkrimet e Murat Bashës për të cilat ai thotë se janë 150, por kam thënë se Murat Basha nuk është autor i asnjë shkrimi të gjatë të llojit të analizës. Ka një dallim mes shkrimeve të mia dhe të Bashës. Shkrimet e mia janë analiza prej disa faqesh gazete, ndërsa shkrimet e Bashës, për të cilat ai vetë thotë se janë pjesë e veprimtarisë së vet të përditshme prej politikani, janë fjalime që ai i mban gjatë mbledhjeve të partisë së vet në mbledhjet e saj në qendër dhe në degët e partisë. Por, këto nuk kanë vlerë të mirëfilltë analitike në publicistikë dhe unë nuk besoj se Murat Basha e quan veten publicist në bazë të tyre.

Aq më pak Basha mund të pretendojë një status prej analisti në bazë të 26 daljeve të veta në televizion të cilat ai me sa duket i koleksionoka me videokaseta apo CD (Unë koleksionoj librat e mij, Basha videokasetat me daljet e veta në tv). Pastaj, në publicistikë dhe debatin publik si kuadri i saj, një autor gjykohet për idetë që hedh dhe unë nuk besoj se ka ndonjë lexues apo teleshikues në Shqipëri që i ka mbetur në mendje ndonjë ide e veçantë nga ato që ka thënë Murat Basha. Basha i përket llojit të politikanëve që flasin shumë, por atij që dëgjon nuk i mbetet gjë në mendje nga ato që thuhet. Pra, ata e trajtojnë dëgjuesin si atë fëmijën që i japin një kovë pa fund dhe e bëjnë ta mbushë me ujë parreshtur. Le të shkruajë Basha tre libra dhe 200 shkrime analitike që gjithsej përbëjnë rreth 600 faqe gazete dhe pastaj barazohemi në statusin intelektual në publicistike.

Tezat dhe antitezat në shkrimet e mia

Sa për atë që thotë Basha se unë në shkrimet me e mia me të cilat ka replikuar Basha, kam kundërshtuar teza të hedhura në librat e mij, kjo është një simptomë e mendësisë së Sheriatit që ka Murat Basha si musliman praktikant që falet pesë herë në ditë. Murat Basha këtu fjalën sigurisht që e ka për ato që kam shkruar unë më parë për Ahmet Zogun, për të cilat ai aludon se janë të kundërta me ato që kam shkruar në dy shkrimet me të cilat ai polemizon.

Murat Basha duhet ta dijë se në konceptin perëndimor të debatit publik, posaçërisht në paraqitjen e përpunuar të ideve, në formën e tezave të argumentuara, nuk ekziston koncepti i dogmës. Një tezë paraqitet mbi bazën e atyre të dhënave që ke në momentin kur shkruan dhe mund të ndryshohet mbi bazën e të dhënave të reja. Pastaj, në librat dhe shkrimet e mia të mëparshme Ahmet Zogu dhe periudha e tij kanë qenë vetëm një subjekt anësor. Në librin tim «Nacional-islamizmi shqiptar: Baleta & Feraj» (2001) të cilit me sa duket i referohet Basha, unë Ahmet Zogut i kam kushtuar kalimthi më pak se një faqe prej 332 faqeve të librit.

Unë, si të gjithë të djathtët, natyrisht që për motive sentimentale, jam pajtuar me mitin historik të krijuar dhe gjeneruar nga zogistët se Ahmet Zogu zbriti nga Burgajeti, një djakë në moshën 24 vjeçare, me dy klasë shkollë të mesme dhe i hyri sfidës së ndërtimit të shtetit modern shqiptar dhe ia doli me sukses të plotë. Në librat e mij, ku Ahmet Zogu dhe periudha e tij janë trajtuar vetëm kalimthi, unë i jam përmbajtur këtij vizioni, pa i hyrë një analize të thelluar, të cilën e pata lënë për ta bërë më vonë.

Më pas, unë i hyra një analize të thelluar të periudhës së Zogut dhe zbulova se miti i mësipërm historik që i rremë. Mrekullinë e ndërtimit të shtetit modern shqiptar në periudhën mes dy luftrave botërore e bënë Britania e Madhe dhe Italia, të cilat patën vullnetin e mirrë për ta bërë këtë dhe dhanë njerëzit dhe fondet financiare për këtë gjë. Ahmet Zogun këto vende e përdorën si një lider dekorativ dhe ky i fundit më tepër i pengoi sesa i ndihmoi. Italia, e cila në periudhën midis dy luftrave botërore financoi ndërtimin e shtetit shqiptar, infrastrukturës, industrisë etj., u tregua shumë e duruar me Zogun i cili përpiqej që të abuzonte sa më tepër me fondet që jepte Italia. Dokumentet diplomatike italiane dhe kujtimet e diplomatëve janë të mbushur plot me ankesa për Zogun, siç e kam cituar në shkrimin tim të mëparshëm. Në dy shkrimet e mia studimore me të cilat ka replikuar Basha, unë kam paraqitur pikëpamjen time përfundimtare për Zogun dhe periudhën e sundimit të tij, pasi jam angazhuar seriozisht në studimin e tyre. Në këto shkrime unë kam paraqitur tezat që përbëjnë akuza për Ahmet Zogun, të cilat Basha i anashkalon pa u dhënë përgjigje. Në mënyrë epigramatike ato janë:

Ja për çfarë e akuzon historia Ahmet Zogun

- 1) Ahmet Zogu që një njeri i pashkolluar.
- 2) Ahmet Zogu në 1912 ua hapi rrugën pa luftë serbëve, ndryshe nga Luma e Dibra dhe me siguri që në këtë periudhë fillon lidhja e Zogut me serbët.
- 3) Ahmet Zogu tradhëtoi Mbretin von Wied duke i marrë parë dhe armë në 1914 dhe duke ikur nga lufta kundër rebelëve islamikë.
- 4) Ahmet Zogu i tradhëtoi austro-hungarezët, kur erdhën në Shqipëri në 1916 duke u lidhur me bullgarët, edhe pse austro-hungarezët i dhanë para dhe gradën honorifike kolonel. Për këtë arsye austro-hungarezët, që atëhere qenë miqtë e vërtetë të Shqipërisë, e çuan në gjysmë internimi në Vienë deri në përfundim të Luftës.
- 5) Ahmet Zogu në 1917 u bë anëtar i Klikës famëkeqe që kërkonte të instalonte në Shqipëri, me terror politik dhe intriga, sundimin e një klani krahinor.
- 6) Për llogari të Klikës Zogu përmbysi qeverinë e dalë nga Kongresi i Durrësit (1918) dhe u bë dorëzanë që qeveria e Klikës e krijuar në Lushnjë të hynte në Tiranë, një veprim ky me pasoja të rënda në rang kombëtar, që vijnë deri në ditët e sotme.
- 7) Ahmet Zogu, si dora e zezë e Klikës, futi terrorizmin politik në Shqipëri, bashkë me Avni Rustemin etj.
- 8) Ahmet Zogu i dha Serbisë toka shqiptare si shpërblim që e rikthyen në pushtet.
- 9) Ahmet Zogu u dha coupe de grace institucioneve demokratike në Shqipëri, pas rikthimit të tij në vend, në dhjetor 1924, gjë kjo krejt e tepërt dhe e bërë veç nga etja për despotizëm.
- 10) Ahmet Zogu bëri gabimin, madje krimin shtetëror, duke u vetëshpallur mbret, në një kohë që Shqipëria ishte Republikë dhe ai që President i saj. Me këtë ai deligjitimoi historikisht të djathtën shqiptare dhe u dha komunistëve një kartë për të legjitimuar diktaturën e tyre të majtë, si një traditë të qeverisjes në vend.
- 11) Ahmet Zogu i çoi në kënetat e Myzeqesë refugjatët shqiptarë nga Kosova e trevat e tjera shqiptare në Jugosllavi, të cilët qenë viktimat e pastrimit etnik serb. Duke mos patur imunitetin natyror për të rezistuar në një mjedis me viruse malarike, gjysma e këtyre vdiqën, çka e fajëson Zogun për genocid, pasi ai e dinte këtë, për shkak se mjekë me origjinë nga trevat përtej kufirit e këshilluan që t' i çonte refugjatët në toka shtetërore rreth Tiranës e Durrësit.
- 12) Ahmet Zogu pengoi zbatimin e projekteve italiane për ndërtimin e Shqipërisë, duke tentuar të abuzojë me fondet dhe duke i kërkuar Italisë shpërblim personal që ta lejonte... të ndërtonte Shqipërinë.
- 13) Ahmet Zogu nuk bëri reformën agrare të shpallur me ligj, duke i lënë vendit një bombë sociale, sidomos në Jug, e cila u shpërthye më pas nga komunistët. Pra, Zogu, për hir të latifondistëve pasardhës të feudalëve turq, praktikisht u dha komunistëve një ushtri bujqish të egërsuar, që i solli vendit diktaturën komuniste.
- 14) Zogu, si satrap oriental që i mban hapur të gjitha alternativat, bëri ligje shumë të buta kundër komunistëve, duke i dënuar me nga 6 muaj internim dhe vetëm në 1939, kur Musolini, si anëtar i Paktit Antikomintern e pati akuzuar se e kishte bërë Shqipërinë vatër të komunizmit, Zogu, për të evituar sulmin italian, bëri gjyqin e 72 komunistëve.
- 15) Zogu në 7 prill 1939 shkeli betimin që kishte bërë si Mbret dhe si Komandant i Përgjithshëm, se do të luftonte për mbrojtjen e vendit dhe dezertoi me turp.
- 16) Zogu bëri në Konferencën e Pezës marrëveshjen me Enver Hoxhën, duke e përçarë të djathtën, duke legjitimuar organizmat e krijuara nga komunistët për të marrë pushtetin, si dhe duke u dhënë mundësi komunistëve të pastronin rradhët e veta, shkatërronin «Ballin Kombëtar» dhe pastaj t' u ktheheshin zogistëve, në luftën për pushtet.

17) Zogu nuk bëri kurrë publike të dhënat e shërbimit të vet secret për krerët komunistë, duke filluar nga Enver Hoxha, edhe pse ka të dhëna se ata qenë agentë të Zyrës Sekrete të Zogut.  
18) Zogu i dha të dhëna regjimit komunist për të gjitha grupet desante që hidheshin në Shqipëri dhe që nuk ishin prozogiste.

Basha i trembet debatit televiziv-kriterit të së vërtetës

Në lidhje me propozimin që i kam bërë unë Murat Bashës që, për të kuptuar opinionin se cili prej nesh është pseudonim dhe cili autentik, të dalim ballë për ballë në një debat televiziv, Basha, duke e quajtur këtë si një kërkesë të çmendur (!?) thotë:

«Lidhur me dëshirën e çmendur të firmëtarit për të bërë debat publik me mua, unë nuk kam asnjë kundërshtim, por do të dëshiroja të bëja debat me shefat e tij sipas rangut. Nëqoftëse firmëtarin insiston, le t' u lutet shefave të shtabit që të na hapin dritare në studiot ku ata bëjnë ligjin, dhe unë do ta pranoj sfidën e të bëj debat me ta». («TemA», 14 nëntor 2004, f. 9.)

Nëse ka vend të përdoret fjala «çmenduri», në sensing e saj më të plotë, ajo do t' i përshtatej shumë mirë autorit të këtij paragrafi, pra Murat Bashës. Kjo për faktin se nuk jam unë ai që e kërkova dhe e fillova debatin me Murat Bashën. Përndryshe, qe Murat Basha ai që reagoi ndaj artikullit tim analitik «Leka Zogu karikatura e Simeonit II: forca e tretë si kolonë e pestë», edhe pse emri i Murat Bashës nuk qe përmendur fare në këtë artikull dhe nuk i takonte atij të përgjigjej para personave që u përmendej emri, duke filluar nga vetë zëdhënësi i LZHK, Fluturak Gërmenji që e ka pasur obligim të dyfishtë të përgjigjej.

Unë kundër-replikova me Murat Bashën, pasi ky i fundit replikoi me mua. Dhe, duke konsideruar faktin se unë jam nënshkruar i një artikulli të shkruar nga të tjerë njerëz, të cilëve Basha nuk ua thotë emrat (ndryshe nga unë që i them se është pseudonim i Abdi Baletës dhe tash edhe i Arian Starovës), unë gjeta zgjidhjen më efektive që opinionin publik të zbulonte se kush nga ne të dy është pseudonim, pra propozova një debat televiziv mes meje dhe Murat Bashës. Unë nuk e kuptoj se përse Murat Basha e quan çmenduri këtë ftesë. I vetmi shpjegim është se ai ka frikë se mos vetëdemaskohet pasi në debatin televiziv do të zbulohet se çfarë ka në kokë ai dhe çfarë kam unë.

Sa për kërkesën e Murat Bashës që debati të bëhet sipas rangut partiak, pra Murat Basha, duke qenë nënkryetar i PLL, mund të polemizojë vetëm me një njeri të rangut të vet, për çka më sugjeron që unë t' u kërkoj shefave të mij të supozuar partiakë, që të dalin në debat përballë Bashës, kjo meriton të quhet çmenduri supreme. Murat Basha duhet ta dijë se në debatin publik, në rastin konkret në rrafsh të publicistikës, nuk hyhet me kredenciale të burokracisë partiake, por me kredencialet intelektuale, respektivisht të gjërave që ke botuar.

Në debatin publik hierarkia është intelektuale dhe jo partiake, si dhe fitohet në sajë të ideve dhe tezave të sjell. Duke replikuar me shkrimin tim, Murat Basha ka hyrë në debatin publik. Në këtë moment ai duhet ta linte pas dëre atributin e tij partiak dhe të paraqitej vetëm si intelektual dhe publicist, për aq sa mund të quhet i tillë. Në rast se Murat Basha dëshiron që të bëjë një debat ndërpartiak për këto çështje ai mund t' i drejtohet PD drejtpërdrejt dhe jo nëpërmjet meje që nuk jam anëtar i PD dhe që në shkrimet e mia e kam kritikuar këtë PD dhe lidhshimin e saj, ndonëse për arsye të ndryshme prej atyre të Murat Bashës.

Por Murat Basha, pasi ka hyrë njëherë në debatin publik duke polemizuar me mua, nuk mund të dalë prej tij kur gjendet ngushtë, duke dashur ta zhvendosë debatin publik mes net ë dyve në një debat të supozuar partiak që Basha e di mirë se nuk ka për t' u bërë kurrë. LZHK ka mbështetur e disa televizioneve ku Basha siç thotë vetë ka dalë 26 herë, prandaj ne fare mirë

mund ta zhvendosim debatin në gazetë në njërin prej tyre. Le të bjerë Basha parimisht dakord për debatin televiziv, pastaj shohim për ta gjetur televizionin.

#### Mbi incidentin Basha-Begeja

Basha pretendon se i është përgjigjur Begesë në debatin në TVA në qershor, kur Begeja e quajti PLL parti të ekstremit të djathtë. Basha do të na i thjeshtonte gjërat sikur të thoshte se çfarë përgjigje i dha, sesa të sugjeronte që të shihet videokaseta e emisionit. Lexuesit nuk i kanë këto mundësi. Por, Basha, me sa duket ka frikë se mos, duke e sajuar përgjigjen, shkakton reagimin e Begesë të cilin sot e ka kryetar të grupit parlamentar të LZHK-së.

#### Mbi Murat Bashën si pseudonim i Abdi Baletës

Në fund të shkrimit Basha thekson edhe një herë se ai nuk është pseudonim i Baletës dhe se Baleta nuk është zëdhënës i LZHK. Në rast se për çështjen e parë (pseudonimin), Basha ka të drejtë të shprehet, për të dytën (ideologun e LZHK) Basha nuk ka asnjë atribut që të reagojë. Basha nuk ka asnjë funksion në LZHK, përveç atij të bodyguard-it rezervë të Leka Zogut. Që Basha është pseudonim kjo kuptohet dhe nga fakti se pesë faqe gazete të dy replikave të tij me mua, përbëjnë një volum të barabartë me më shumë gjysmën e 150 shkrimeve që ai ka shkruar gjatë këtyre viteve.

Sa për ato që ka shkruar Basha në vitin 2001, në rast se ai pranon debatin televiziv unë mund t' i citoj shkrime që ka botuar për çështjen të cilën ai e mohon edhe në gazeta të tjera. Me sa duket dhe kjo histori do të dalë si ajo e udhëtimit të Gërmenjit në Johannesburg. Lapsusi i vajtjes së Gërmenjit në Johannesburg u bë qëllimisht nga autori i vërtetë i shkrimit, Baleta, i cili qe vetë në Johannesburg. Me këtë Baleta donte të maskonte autorësinë, që dukej qartë nga stili dhe tezat.